PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë 44 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

**Altin Meçja – Anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Z. Kryetar mbledhja duhet të jetë live, jeni në kundërshtim me rregulloren.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mbledhja po rregjistrohet, për arsye teknike nuk po trasmetohet live.

**Erion Murataj - Anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Dua të tërheq vëmendjen, ku është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit të kaluar? Do shkosh për falsifikim aktesh për dy pika që i ke kaluar njërën me 24 dhe tjetrën me 26. E dyta sot keni sjell rendin e ditës dhe ke dy kërkesa, ke një të banorëve të Njësisë Administrative Gjergjan e cila ka ardhur prej muajsh në Bashki, sot je në kushte me 0 komunikim për komisionin hetimor, e cila ndikon tek ky Këshill, dhe para se tit më japësh një përgjigje, sic është dhe propozimi i një shoqate për dhënie tituli qytetarë nderi, ti sjell një rend dite pa procesverbal për tu miratuar. Unë tani e kuptoj që ti e ke kapur filmin por je i filmuar. Thoni që ka defekt. Keni bërë një ndryshim për sallë mbledhjesh dhe doni të na coni në hotel, në hotel shkojnë disa njerëz të tjerë. Reflekto mbi kërkesat që keni në tavolinë.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Do ta sjellim muajin tjetër për miratim procesverbalin.

**Blendi Himçi – Anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Sot është mbledhja e Këshillit Bashkiak e rradhës dhe e ke nisur në shkelje procedural në të gjithë pikëpamjet e shkeljes së rregullores. Së pari nuk mblodhe mbledhjen e kryetarëve, ku caktohet rendi i ditës. E dyta vazhdon të na trajtosh me arrogancë, të përdoresh nga kryetari i bashkisë është e patolerueshme. Na ndërrove përsëri dhe na thua jo atje jo ktu. Ju në vend që të merrni masa për ta impenjuar administratën dhe për ta vënë para përgjegjësisë për të përfunduar sallën, na hiqni nga një sallë ku ka kushte komode, në këtë sallë ku nuk ka asnjë kusht. Ju vazhdoni dhe na hiqni dhe këtë mundësi. Ky është abuzim. Pse mbledhja nuk është live, nuk ka justifikim ka një defekt, kishit kohë të merrni masa për të vendosur teknikën. Nuk e kuptoj pse vazhdohet, kërkojmë vetëm zbatimin e rregullores. Deri kur do vazhdojë kjo fasade, nuk lat as kohë të mjaftueshme pasi materialet ishin të rëndësishme, materiale për taksat dhe ju nuk na latë kohë të diskutonim në komisione. Kishim të gjitha kushtet për ta spostuar. Unë ju ftoj të ngriheni në pozitat e Kryetarit të Këshillit Bashkiak, nëse ndiheni të dikuar jep dorëheqje.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë nuk jam përdorur Z. Blendi, përkundrazi, lidhur me faktin qe ju nuk keni pasur kohë për të lexuar materialet, nuk ka në asnjë rregullore dhe ligj që nga momenti që mblidhet kryesia lihet një hapësirë. Nga momenti që komisioni mblidhet janë 5 ditë afat që materialet të sillen para mbledhjes së këshillit. Nuk shprehet 5 ditë para komisioneve. Përsa i përket përcaktimit të datës, vendit dhe orës së mbledhjes ka dy forma,njëështëkryesia
që përbëhet nga Kryetari, zv.kryetarët dhe sekretari, dhe kur e shikojnë të arsyeshme ftojnë kryetarët e grupeve, është tek Neni 12 dhe Neni 21 i rregullores. Unë mblodha Kryesinë. Nuk ka asgjë të keqe nëse do ishin. por nuk ka asgjë të keqe edhe mos të ishin. Kryesia cakton datën, vendin dhe orën. Lidhur me sallën keni të drejtë Z. Blendi. Ne e kishim vendosur ta përfshinim në rendin e ditës, por këmbëngulja e përfaseqeses dhe të tjerëve tuaj pse të shkojmë atje, duke përdorur dhe epitete jo të hijshme, bashkë me komisionin e ekonomisë më pas vendosëm ta hiqnim dhe ta bënim mbledhjen këtu. Por këta nuk kanë të drejtë që ta heqin nga rendi i ditës, pra

e lam në rend dite që ta votojmë këtu. Lidhur me sallën kur do bëhet përfaqësuesit e bashkisë janë këtu.

**Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Po jua bëj pralajmërim publik edhe ty Gledjan, në rast se shkoni atje mesazhet që i keni cuar porosi pronarit të hotelit do shkojnë tek dhoma, mos e bëni gafën. Janë cuar këshilltarët atje me mesazh. Nuk ka shance të kaloj kaq po them. Do ti bëj publike do ti coj dhe prokurori.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nga ky moment nuk do të flasësh pa leje.

**Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Nuk të kërkoj leje ty.

***Pika e parë miratimi i rendit të ditës.***

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

***Pika e dytë dhe e tretë***

1. ***Mbi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Shtator 2024.***
2. ***Mbi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2024.***

**Zamir Muzhaqi – Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Cunat e policisë ose uluni zini vënd në sallë ose dilni jashtë

**Aurora Domi-Anëtare ë Këshillit Bashkiak Elbasan**

Cne që janë ktu present mund të na I shpjegoj ndonjëri?

Kemi të drejtë ta dimë për cfarë duhen?

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

***Pika e katërt e rendit të ditës***

***Mbi dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z. Ymer Balliu.***

**Luiza Popja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Komisioni I mandateve I përbërë nga Luiza Popja,Rudina Mita dhe Fatmir Vodollari Shqyrtoi dokumentacionin për dhënien e mandatit të Z.Ymer Isuf Balliu,pas krijimit të vakancës të kualicionit Bashkë fitojmë është dërguar njoftimi tek komisioni qëndrir I zgjedhjeve nga sekretarjati I këshillit Elbasan dhe komisioni qëndror I zgjedhjeve ka marrë vendim për plotësimin e vakancës më kandidatin e radhës nga lista emërore e kualicinit Bashkë Fitojmë Z.Ymer Isuf Balliu pasi ka dorzura dokumentacionin përkatës.Vendimi është një Mirati I publikuar dhe në faqen zyrtare të komisionit qëndror të zgjedhjeve dhe me shkresë nr.21më datë 10 Tetor të 2024 është dërguar ky vendim për procedura të mëtejshme.Ne si komision konfirmojmë mandatin për Z.Ymer Isuf Balliu

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Lexon formulën e Betimit.

Këshilli Bashkiak me 43 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

***Pika e pestë e rendit të ditës***

***5.Mbi miratimin e marrëveshjesh së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe A.SH.K***

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Ka qenë një material që nga mbledhja e kaluar,është po I njëti relatim që bëmë ke mbledhja e kaluar.Eshtë një marrveshje e cila bashkia e Elbasnit në bashkëpunim me ASHK të bashkëpunojnë të dyja bashkë për procesin e legalizimit për mbylljen e këtij procesi sa më shpejtë të jetë e mundur,një pjesë e cështjeve është administrative,miratimi marrveshjes pasi ka dhe disa angazhimë financiare për njerëzit të cilët do të angazhohen në këtë sektor.Eshtë një marrveshje që lehtëson procedurat e qytetarëve të elbasanit,angazhohen kryepleqtë në njësitë administrative por edhe inxhinjerët e Bashkisë Elbasan,do të jetë një strukturë e pasacme pranë bashkis që do të ndihmojë të gjithë personat që kanë problematik,sot procesi I legalizimit është një problematic të cilat hartat të cilat maten kanë një vlershmëri prej tre muajësh dhe kërkohet një angazhim në terren gjatë gjithë kohës,duke qënë që bashkia ka lidhje të drejtpërdrejtë me kryepleqte e njësive administrative është një hallkë që do ti vi më shumë në ndihmë qytetarëve.Ne kemi filluar ktë javë intesivisht në njësinë administrative Bradashesh,Shirgjan në të dy njësitë administrative të cilat ku kalon dhe baypasi Elbasanit për të mbyllur sa më shpejtë procesin aty sipas parashikimeve,në këtë moment janë ngritur 9 grupe pune në terren dhe një jesë tjetër në zyrë që të merret me përpunimin e hartave dhe informacionin e të dhënave.Ajo që është bëre me vendimin e ministrave që është një hap shumë pozitiv është që kto grupe pune nga inxhinierët tonë do të njihen dhe nga sistemi I ASHK-së,kjo marrëveshje bënë të gjithë këtë procedurë të jetë sa më efikase në ndihmë të qytetarëve të elbasanit.

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

I nderuar Kryetar,të nderuar kolegë,cështja e legalizimeve është me ligj është miratuar që ne 2006,dhe nuk I kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare qytetarëve

Ndrohen qevertitë,ndrohen kryeministrat,miratohen struktura dhe ky problem nuk ka marrë zgjidhje akoma.Nga ky problem unë njoh shumë njerëz që janë të prekur dhe presin që të marri zgjidhje cështja.Kjo marrëveshje është një bashkëpunim midis Bashkisë dhe Kadastrës,nuk e di se cfarë mund të bëjë bashkia por shpresoj që kjo marrveshje ti jap zgjidhje.Por jam pak skeptik sepse është një gangrene që është kthyer për shtetin tonë prej 18 vitesh,shpresoj që kjo nisem të mos kthehet në dicka që do të përdoret polotikisht dhe për të fituar zgjedhjet që po afrojnë,por nuk besoj se do të zgjidhi dicka sic e dimë të gjithë kush ka njohjet e duhura dhe kush shkon nëpër dyert e duhura dhe njeh njerzit e duhur mbaron punë me legalizimet sepse njohim pa fund njerëz që kane mbaruar punë dhe ata të cilet presin që ligji dhe e drejta e tyre si qytetar ata për fat të keq,nje ndër to është dhe një njeriu im që është pronar dhe në pronën e tij askush nuk I ka rënë derës ti thotë dhe pse e ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe sa herë është thërritur ka shkuar dhe I ka plotësuar vazhdimisht nuk ka shkuar tek njerzit e duhur dhe ai është duke pritur që shteti tja legalizoj por ai ka vendosur që mos I bjeri këtyre dyerve por ta presi nga shteti dhe un pres që kjo marrveshje të jetë në këtë frymë që ti japi zgjidhje qytetarëve dhe të marrin të drejtën e tyre.një shtet që nuk zgjidh dot prej 18 vjetësh problematikat e qytetarëve

**Ilirjan Sadiku-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Na jep ndonjë sugjerim?

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mos I trokisni atyre dyerve që të marrim legalizimin,miratoni ligjin qartë dhe pastër që në cdo qytetar të shkoj shteti ti bjeri derës ti kërkoj tarfiën që duhet të paguaj dhe nëse ka një masë që ai duhet të paguaj dhe te zgjidhet,është cështje e shtetit cështje vullneti që nuk doni ta zgjidhni dhe sa herë vijnë zgjedhjet shohim kryeministra që shpërndjanë certifikata pronësie.Nëse ju bezniseni nga fjala e lirë nuk është problem im.

**Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Je kryetar I këshillit bashkiak stë vjen zor nderpritet fjala këshilltarit

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nuk e di pse I vjen kjo bezdi nga fjala,po krijohet nje mendtalitet dictatorial që ndërpritet fjala ,dhe nëse e them gabim fjala e lirë është e lirë.me iku mendimi sepse zhurma ti largon.Nuk kam anjë lloj përfitimi nga legalizimi apo kam cështje personale e ka thjesht parimore për qytetarët.

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Qëllimi është të fokusohemi në zona.Dua ti bëj një thirrje publike të gjithë qytetarëve nuk do të thotë që procesi I legalizimit të përfufunojë me legalizimin e objektit ka dy faza ose përfundon me sjkualifikimin dhe me kualifikimin e legalizmit,por e dimë që I japim një zgjidhje problematikave kryesore,që të bëhët ky process duhet që qytetarët të jëne në banesat e tyre në mënyrë që grupi I punës të futet dhe të bëjë matjet përkatëse të banesave,ktë ka si qëllim ky process që ne po marrim pro futemi në një zonë në një fshat,krye plaku I fshatit bashkë me njësinë administrative ka bërë lajmerimin tek banorët të cilët kanë probleme me legalizimet apo jane ne process legalizimi në të gjitha rastet e procedurave tona pavarsisht që është mbyllur si process por ne do ti bëjmë për llogari tonën do të futemi tek jë zobë dhe do ta mbyllim.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Gazetarët ju lutem kaloni në fund

**Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Për sa kohë ti nuk e ke live lëri gazetarët të filomojnë.Është e turpshme kjo që po bëni,qëndro në lartësinë e duhur mos u merr me gazetarët.Së pari kjo marrrëveshje po miratohet 6 muaj para zgjedhjeve dhe po përdoret politikisht,që nesër te merret vota nëpërmjet të gjithë atyre kryetarëve të fshatit që I ka të partisë socilistë,që do trokasin nëpër dyert për të kërkuar votën,Nëse kryetari do të ishtë kaq I vullnetshmë të kishtë mbaruar azhornimin e tokave të fshatrave dhe lagjeve të Elbasanit I cili ska mbaruar akoma azhornimi.Vazhdojne ndërtime pa leje,nuk është marrë asnjë masë,ka një IKM që I le qëllimisht.Bashkia po bën rolin kryesor politik.Ne do të jemi kundra ksaj marrveshje jo për dëmin e qytetarëve por pse po përdoret politikisht.

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Është një marrveshje që vjen në bazë të Këshillit të ministrave.kryepleatq janë zgjedhur nga populli nuk janë zgjedhuar as nga partia socialiste as nga partia

demokratike,kanë një rol të rëndësishëm të përcaktuar me ligj që merrem me komunitetin dhe kur komuniteti ka një problematik është kryeplaku I pari që bën njoftimet sic janë dhe kryetarët e qytetit kanë disa role të përcaktuara.Për sa I ~~përket azhornimit të tokës ne kemi pasur vullnetin që në fshatrat ku ska azhornim toke të bëhët azhornimi I tokës dhe ky është hapi I parë që në marrveshjne me~~ ASHK marrim përsipër disa të drejta dhe ne si pushtet vendor për tu marrë me azhornimin,I cili do ti japë decitralizimin e ve.shumë nga kopetencat e pushtetit vendor ashtu sic është dhe kadastra të kalojnë në pushtet vendor pasi është kopetencë e drejtpërdrejtë e pushtetit vendor dhe ky është hapi I parë që ne të kalojmë ne decetralizim dhe unë e shikoj shumë positive ktë gjë,nuk po merremi për të fitaur zgjedhjet dhe as nuk është proces zgjedhjesh.Nuk marrin të gjithë legalizim ka dhe nga ata që skualifikohen për shumë arsye.

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përderisa është për një afat një vjecar,kjo marrveshje është nënshkuar ashtu sic thatë dhe ju për të kaluar dhe në kopetenca të Bashkisë

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Ne jemi të aftë që do ta mbyllim procesin shumë shpejtë dhe do të jëmi klasifikues për të mirë të qytetarëve

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo duhet të jetë pa afat,kjo marrveshje nuk zgjidh gjë është thjesht vullnet poltik,nuk ka pseë shpenzohen para as nerva qytetarësh kujt ti legalizohen le ti legalizohen,kujt është për tju prishur le ti prishet.

**Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mjafton që të lexojmë pikën q,d dhe e duke epërfunduar me f në nenin 6 të kësaj marrveshje për të kuptuar që nuk është politike.Pasi sot do të flasim për legalizime në këtë sallë të dyja klanet kanë bërë legalizimet e veta dhe kanë kusuret e vet mbi kurriz.Kryetari tha që është hapi I parë drej decetralizimit në Elbasan ne e dimë e kemi defakto,tani ne kur lexojmë kto pikat Sa leje ndërtimi pallatesh janë dhënë?Të përfundosh një process I cili ka nisur shumë herët duke skualifikuar apo duke kaluar disa që ende nuk e kanë legalizuar objektin e tyre kanë interesa të mëdhaja mbrapa.Bashkëortakësia ktu në këtë sallë është e madhe dhe pastaj topi hidhet nga politika jo.Është për interesa personale,financiare dhe lejet e

ndërtimit,nuk është për interesa politik.Ta marrin vesh qytetarët kaloheni mos beni farse dhe suksese.

**Eva Bica-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

~~Kam një merak që kjo marrëveshje në fakt dhe afati dhe të gjitha parashikimet nga~~ këshilli I ministrave më vendimin 435 datë 26.06.2024 duke përfshirë dhe marrveshjen e cila është shtojca A e kësaj VKM-je kshuqë të gjitha kto retorika qe ju keni për të bërë politikën e ditës mir se të vinë.jemi të gjithë dakord që kjo marrëveshje do të lehtësojë dhe do të sjelli një përshpejtim të procesit të legalizimit për të gjithë qoftëë të majtë apo të djathtë.

**Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak**

Ndërko qe ju kryetar relatuat këtë cështje ndër të tjera thatë ne do të përfshimë në këtë process matjesh dhe legalizimi edhe nëse nuk janë përfshirë më përpara ato ndërtesa që nuk janë përfshirë deri tani.Si do garantoni ju transparencën e këtij procesi dhe so do të na e vërtetoni ne që në atë process nuk do të përfshin dhe ndërtimet pa leje që janë identifukur?

Si e justifikoni ju mosprezencën e inspektorjatit të mbrojtjes së teritorit në terren?të dal un dhe mos dalë inspektorjati sësht normale? Si do na e tregoni ju që tek kto lista nuk do hynë kto ndërtime që po bëhen sot?

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

E kuptoj shumë mirë pjesën tuaj politke dhe të gjitha kto spekulime pse është ky në terren pse sësht ky.ka një bazë ligjore që të ka lënë një detyrim që der kur është legalizimi ka ca ortofoto apo jo e keni kaq informacion.Për ato njerëz që kanë qënë në emigracion dhe nuk kanë pasur mundësi,jan rreth 500-600 familje në Elbasan që nuk kanë pasur mundësi të kapin datën e aplikimit sepse kanë qënë në emigracion kur u mbyll ne vitin 2020,nuk kanë qënë fizikisht në shqipri të bëjnë procesin e regjistrimit.Kam qënë un I pari që kam kërkur liberalizimin ,lejen e ndërtimit dhe sidomos cative të fshatrave,për një gardh,apo banjot që I kanë në fund të baces dhe ktu janë thjeshtuar të gjitha lejet e zonave rurale.Lejet e ndërtimit në zonat rurale janë thjeshtësuar shumë

**Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak**

Ky është proces I vetëdeklarimit dhe ka të bëjë më shtesa dhe të ka ndihmuar ligji.

Po flas për ndërtime nga themili,jo për mure,spo e bej politike politike po ebën ti

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në njësinë Adm,Shushice mund të jenë nja 50 rastë me gjobitje

**Zamir Muzhaqi-Nënkryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

E para përmendi që po bëni spekulime dhe e dyta po bëni populizëm në këtë sallë angazhimet e bashkis për ti shërbyer qytetarëve të Bashkis Elbasan janë shumë të mirëpritura por angazhime të tilla të cilat vinë para zgjedhjeve janë angazime të cilat ne kemi shumë të drejtë që ti paragjykojmë.Ne vitin 2021 një nga problematikat e mëdhaja të opozitës së shqiprise dhe e certifikuar nga OSB odiri ishin pikërisht ndërhyrje të tilla të qytetarëve shqiptar për marrjen e certifikatave.E dyta sim und të mos e shohim ne politike moelin cyrbja jep kne certifikata dhe merr nga ana tjetër mandate.Jam I detyruar që ta shikoj dhe politikisht këtë cështje si dhe të gjithë këshilltarët e tjerë që duan ta shikojnë me ktë sy.Angazhimi juaj pët ti shërbyer qytetarëve të Elbasnit është gjithm I mirëpritur por angazhimi juaj për te mbushur rrjetet sociale me kto certifika nuk me duket drejtë.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 16- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

***Pika e gjashtë e rendit të ditës***

***6.Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.116 datë 30.11.2023"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan,për vitin 2024".***

**Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Bashkia nisur nga rekomandimet që ka dhënë drejtoria e përgjithshme e pasurive në Tiranë kanë përcaktuar më saktë disa taksa të pusurisë që përfshihet taksa e ndërtesës,e tokës dhe e truallit janë thjesht ndryshime të formulimeve dhe nuk ka asnjë ndryshim të tarifave të taksave pra janë thjesht formulime të Neneve sipas rekomandimeve që ka dhënë drejtoria e përgjithsgme e pasurisë ndërsa tek tarifat e transportit është shtuar pika 1c për parkimet e revervuara të istitucioneve në fshat dhe qyetet ku bashkia ka asksione dhe tarifa të përcaktura 15 mijë lkë në vit pra I vetmi ndryshim tek tarifa parkimeve që bëhet në vendim,Njëkohësisht në këtë vendim tek klubi shumëspotësh pas pikës 3 të shtohet pika c ku të përjashtohet nga tarifa e përdorimit të stadjumit Elbasan Arena klubi I futballit të Elbasanit që do të bëjë ndeshjet dhe marrveshja që ka FSHF me stadjumin Elbasan Arena për ndeshje ndërkombëtare,prat ë dyja kto do të përjashtohen nga tarifat.Në komision u miratua ky vendim I ftoj kolegët ta votojnë sepse nuk ka ndryshime thelbësore të tarifave të taksave vendore.

**Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Për sa I përket këtij draft propozimi lidhur me miratimin e taksave dhe tarifave një pjesë të tyre,ato taksa që sapo relatoi kryetari I komisionit të financës janë taksa të cilat drejt për së drejti e prekin pak atë që është qytetar I thjeshtë.Taksa më e rëndësishme e cila ka qenë një taksë ezistence por jo e vjelur nga qoftë plotësisht apo jo është taksa mbi ndërtesën është një taksë e cila përllogaritet si 0.5% e vlerës për metër katror të një ndërtese me referencë për qytetin e Elbasanit 51300 lekë për

metër katror,është një taksë e cila kërkohet me ngulm që të vilet ndoshta për herë të parë sepse gjendja e taksave në bashki është shum e dobët.Por duhet të kemi parasysh dicka sa herë që flasim për taksa flasim për futje dore në xhepin e qytetarëve dhe sor ~~Elbasani është një nga qytetet më të varfra në shqipri pas Kuksit dhe është e papranueshme vendosja dhe vjelja e ksaj takes tani në fundvit për aq kohë sa përpara~~ ksaj ndoshi dicka jo e pranueshme u bllokuan llogari të qytetarëve,për vjeljen e një takes shumë më të thjeshtë sesa kjo që ishte tarifa e pastrim-gjelbërimit,u krijuan ngërce u krijuan shqetësime,latë familje të tëra me ditë të tëra në një gjendje të papranueshme sepse keni bllokuar llogari page qesharake dhe sot vimë I shtojme dhe ktë sikur mos mjaftonte ajo që bëmë.Për këtë arsye për të mos rënduar Akoma më tepër xhepat e qytetarëve të Elbasanit dhe për faktin që dhe metri katror nuk është më 51 mijë e 600 dhe kjo është një taksë që ka shkuar dhe ka favorizuar ndërtusin,ne si grup këshilltarësh të partis demokratike shprehemi kundër vendosjes së ksaj takse dhe vjeljes ndaj qytetarëve.

**Aulona Bylykbashi-Nënkryetare e Bashkisë Elbasan**

Kjo është një taksë ekzistuese nuk është që duhet ta votosh për ta shtuar apo për ta hequr ,taksa e pasuris apo e ndërtetsës që është materiali që ju shpreheni nuk është një taskë e re,është taksë ekzistuse që është miratuar në paketën fiskale po nga ju.Ajo që është bërë gje e cila të gjithë anëtarëve të komisioneve I është shpjeguar në mënyrë të detajuar në komisin janë shtuar vetë përkufizime ligjore si jë sugjerim që ka ardhur nga drejtoria taksës së pasuris në ministrin e financës dhe është shum e kuptueshme nëse I referohemi materialit është neni 3 ishtë bëhët dhe është shtuar vetem paragarfi përkufizus dhe me të njëjtën formë dhe frymë ecet me të gjithë materialin deri posht,pra ne ktu nuk votojmë sot për të shtuar apo për të hequr këtë taske e cila jo vetem ka qënë eksistuese dhe vilet prej vitesh vazhdimisht sipas përcaktimeve ligjore por është thjesht sqaruese.

**Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kisha një pyetje për sa kohë inceneratori nuk punon dhe vazhdon të mos punojë pse nuk ulet tarifa e pastrimit për familjet dhe bizneset?Sepse në diskutimin që është bërë arsyetimi që është dhënë është ricenerimi I mbetjeve urbane prandaj po kërkohet kjo gjë,gjatë gjithë vitit nuk punon inceneratori dhe vazhdon të mos punojë mali me plehra vazhdon dhe rritet dhe ne nuk e dimë kur do ta rinisi punën inceneratori dhe kur do të bëhet asgjesimi I të gjithë atyre mbetjeve urbane që janë buzë shkumbinit.Pse nuk ulet kjo tarifë e shërbimit të pastrimit për aq kohë sa inceneratori nuk punon?

**Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Nuk besoj se kishte lidhje me materialin kjo,thjesht për sqarim taksa e pastrimit që merret është taksë për trajtimin total të mbetjeve.Ka filluar dhe ktë vit puna për llogaritjen e tarifës së pastrimit,Ajo që sot po kalojmë është një gjë thjesht,ashtu sic e tha dhe nënkryetarja që është sqaruar në komision është një pjesë e përkufizimit sqaruar as rritje tarife as ulje tarifës.është një problematic që ne kemi pasur për ndërrmarrjet shtetërore dhe për SH.A-të të cilat disa nuk paguanin tarif për vend parkimin e tyre por e kishin të domosdoshme që të kishin një vend parkimi në ambjentet e tyre,duke qënë se e marrnin pa pagesë deri sot kemi bërë një unifikim të shpenzimeve.

**Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo është në vrazhdën e asaj që ndoshi para pak kohësh që u bllokuan llogaritë bankare,kishte vite që rrinte në bashki dhe nuk vilej dhe bashkis I vjen në mëndje duke e vjelur këtë taksë,Ajo që ndoshi që familjet e reja që kishin bërë ndarje nga familjet ekzistuese I përfshintë kjo taksë që duhet të paguanin dhe ato nuk e dinin dhe bashkia nuk e ndërmorri hapin që ti informonte,por bllokohet direct llogaria bankare.E njejta gjë mund të ndodhi dhe me këtë taksë,kjo takse eskziston por për ato që nuk j akeni vjelur,apo llogaritur vjen një ditë dhe gjen llogarin bankare të bllokuar.I bëj një thirrje qytetarëve nëse ju bllokohet llogaria bëhët fjalë për taskën e cila bashkia sot do ta vjeli sepse ka keq punën e buxhetit.Se kuptoj pse e keni keq kur keni rritur rrogat në mënyrë të pa llogjikshme.

**Aulona Bylykbashi-Nënkryetare e Bashkisë Elbasan**

Të bëj dhe një sqarim,bllokimi është bërë për debitorët,kjo që ju keni konstatuar,Të gjitha tarifat dhe taksat janë të miratuara sipas familjeve në gjëndjen civile.të gjithë ata që kanë një kryefamiljar si familje duhet të paguajnë tarifat dhe taksën e pasuris e paguajnë vetëm pronarët e godinave përkatëse.Debitët që ju po I referoheni janë që nga viti 2016 dhe nuk është hera e parë që bashkia kryen procesin e bllokimit të llogarive,nuk e di pse është bërë kaq sensitive ktë vit ky proces.Nuk kemi bërë asgjë me shkelje me ligjin,është një process që e përcakton ligji,është detyrim ligjor qe cdo qytetar duhet ta paguaj për shërbimet që marrin

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 5- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.10.2024, ora 13:05 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

***Pika e shtatë e rendit të ditës***

***7.Mbi miratimin e nivelit të pagave për administratën e bashkisë dhe institucioneve vartëse.***

**Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

